




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECANI



Në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të dt.16.01.2018, nr.01-1478, për kompenzim të mjeteve buxhetore të cilat shpenzohen për bartjen e pacientëve të dializës, duke u mbështetur në nenin 40.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 pika 3. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.31.01.2018, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR KOMPENZIM TË MJETEVE BUXHETORE PËR BARTJEN E PACIENTËVE ME DIALIZË

#### I.

Merret Vendimi për kompenzim të mjeteve buxhetore të cilat shpenzohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) për bartjen e pacientëve të dializës, në shumën prej 17.607.20 € Komuna për nevojat e QKMF-së për bartjen e pacientëve me dializë do të bëjë blerjen e automjetit për bartjen e pacientëve në shumën e lejuar deri 17.607,20 € nga Linja buxhetore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kodi (17515)- pozicioni blerja e veturave zyrtare.

#### II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa të KK Deçan.

#### III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

#### IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i Komunës Deçan.

01.Nr.I-13/2

Deçan, dt.31.01.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit :  
Haki Shehaj

